FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

ATROPINE

Tretësirë për injeksion – 1 mg / 1 ml (0.1%)
(Atropinë sulfat)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor, që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë është Atropine dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Atropine
3. Si ta merrni Atropine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Atropine
6. Informacion i mëtejshëm.

1. ÇFARË ËSHTË ATROPINE DHE PËRSE PËRDORET

Lënda aktive e këtij preparati është atropinë sulfat, e cila ka një veprim antimuskarinik. Atropina bllokon përkohësisht fundet e nervave, sekretimin e gjendrave, relakson disa muskuj si dhe shton rrahjet e zemrës.
Ky bar përdoret:
- si paramjekim përpara anestezisë, për të ulur sekretimin e gjendrave të pështymës;
- për të trajtuar gjendjet e karakterizuara nga rrahje të dobëta të zemrës, si për të rikthyer numrin normal të rrahjeve të zemrës gjatë një arresti kardiak;
- për mjekimin e spazmave të aparatit tretës, kolikave të fshikës së tëmthit e të kolikave renale (kombinuar edhe me ndonjë analgjezik të përshtatshëm);
- për trajtimin e helmimeve të shkaktuara nga kërpudha që përmbajnë muskarinë si dhe në helmimet e shkaktuara nga pesticidet fosforoorganike.

2. PËRPARA SE TË MERRNI ATROPINE

Mos përdorni Atropine në qoftë se:
- jeni alergjik ndaj atropinë sulfatit ose ndaj lëndëve ndihmëse të këtij preparati;
- vuani nga glaukoma me këndë të ngushtë;
- keni hipertrofi të prostatës;
- vuani nga myasthenia gravis;
- vuani nga ileus paralitik (në këtë rast zorra ndalon së funksionuari normalisht);
- vuani nga koliti ulcerativ;
- vuani nga stenoza e pilorit.

Tregoni kujdes të veçantë me Atropine
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se:
- keni vështirësi në urinim;
- kaloni pamjaftueshmëri të zemrës;
- keni patur arrest kardiak;
- vuani nga sëmundje obstruktive kronike pulmonare (gjendje kur rryma e ajrit në pulmone reduktohet dhe ju mund të keni kollë e të ndiheni sikur po mbyteni);
- keni një tiroide me aktivitet shumë të lartë;
- keni temperaturë;
- keni diarre;
- keni refluks ezofageal.

Marrja e barnave të tjera
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë. Informoni mjekun tuaj në qoftë se jeni duke marrë ndonjë prej këtyre barnave:
- barna për mjekimin e psikozave ose të depresionit;
- amantadinë (bar për trajtimin e sëmundjes së Parkinsonit);
- antihistaminikë (barna për trajtimin e alergjisë);
- barna për rregullimin e funksionimit të zemrës (disopiramid dhe meksiletin);
- ketokonazol (bar për trajtimin e infeksionit mykotik);
- barna të ndryshme që mund të merrni dhe që kanë nevojë të treten në gojë për të dhënë veprimin e tyre. Kjo sepse, atropina mund të shkaktojë tharje të gojës, duke e vështirësuar akoma më shumë tretjen e këtyre barnave.

Shtatzënia ose ushqyerja me gji
Në qoftë se jeni shtatzënë ose ushqeni fëmijën me gji, mendoni që jeni shtatzënë apo planifikoni të ngeleni shtatzënë, njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni këtë bar. Mjeku ose farmacisti do të diskutojë mbi rreziqet dhe përfitimet e marrjes së tij.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk duhet të angazhoheni në punë që kërkojnë vigjilencë të plotë mendore, si: përdorimi i makinerive të rrezikshme apo drejtimi i automjetit.

3. SI TA MERRNI ATROPINE

Atropine, tretësirë për injeksion është bar që merret me injeksion në muskul, injeksion nën lëkurë ose në venë. Gjithmonë injektimi i këtij bari duhet bërë nga mjeku ose nga infermieri i ngarkuar për këtë punë.

Dozimi: *Me injektim nën lëkurë ose në muskul:* Të rriturit, 0.5 – 1 mg 1 deri në 2 herë në ditë. Fëmijët deri në 1 vjeç, 0.2 mg; 1 - 6 vjeç, 0.2 – 0.5 mg; 6 - 15 vjeç, 0.3 – 0.5 mg 1 - 2 herë në ditë.
Doza maksimale e njëhershme nën lëkurë është 1 mg, ndërsa ajo ditore është 2 mg.

Injektim në venë: Në këtë rast dozat janë 2 - 4 herë më të vogla në krahasim me ato që injektohen nën lëkurë ose në muskul.

Në helmimet me lëndë fosforoorganike mund të shpëtohet jeta e të helmuarit po të ndërhyhet në kohën e duhur dhe me doza të mjaftueshme. Zakonisht injektohen menjëherë nën lëkurë ose në muskul 2 - 3 mg, kurse pas 2 minutash injektohen edhe 2 mg të tjerë. Me këto doza pakësohet djersitja e theksuar dhe shfaqen shenjat e mbidozimit të atropinës si midriazë apo tharja e gojës.

Në qoftë se keni marrë më shumë Atropine
Meqenëse si dozimi, edhe mënyra e administrimit të këtij preparati përcaktohen nga mjeku si dhe nga fakti që administrimi do të bëhet vetëm nga personeli mjekësor i specializuar, mundësia për ngatërrim të dozimit apo harrim të marrjes së dozës pasardhëse është shumë e vogël. Në qoftë se gabimisht ju është dhënë dozë më e madhe sesa duhet, shenjat që mund të keni janë: rrahje shumë e shpejtë e zemrës, frymëmarrje e shpeshtë, temperaturë e lartë, ndjenjë lodhjeje, gjendje e të ndjerit konfuz, dhe halucinacione.
Menjëherë duhet të njoftoni mjekun ose infermierin që ju bën administrimin e barit.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore! Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre!
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson:
- turbullim i shikimit;
- tharje e gojës e shoqëruar me vështirësi në gëlltitje dhe në të folur;
- reduktim i sekrecioneve bronkiale;
- zgjerim i bebes së syrit me çrregullim të akomodimit dhe ndjeshmëri ndaj dritës; rritje e presionit intraokular;
- skuqje në fytyrë;
- ndjenjë të nxehti;
- tharje e lëkurës;
- ngadalësim i rrahjeve të zemrës ndjekur nga rrahje të shpeshta të saj;
- vështirësi në urinim ose kapsllëk;
- nauze, të vjella;
- konfuzion;
- përgjumje.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI ATROPINE?

Mbajeni larg fëmijëve! **Atropina është helm i fortë!**
Mos e përdorni tretësirën për injeksion Atropine pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim!
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban tretësira për injeksion Atropine
Lënda aktive është atropinë sulfat.
Çdo ampulë 1 ml përmban 1 mg atropinë sulfat.
Lëndët ndihmëse janë: acid klorhidrik, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 10 ampula.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Tetor 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.